# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare**

**www.legjislacioni.gov.al**

**Nr. 93** **Datë 19 qershor 2014**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 52/2014<br>datë 22.5.2014 | Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit ........................... | 3685 |

# LIGJ
# Nr. 52/2014

## PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Objekti

Ky ligj rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

### Neni 2
### Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, si dhe operacioneve që lidhen drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 3
### Autoriteti përgjegjës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

### Neni 4
### Përkufizime

I. Në këtij ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrator" është personi i përcaktuar në nenin 158, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
2. "Administrimi i rrezikut" është tërësia e metodave dhe e rregullave që përdoren nga shoqëria e sigurimit për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve të mundshme, me qëllim shmangien e humbjeve financiare.
3. "Aksionar influencues" është aksionari, i cili ka pjesëmarrje influencuese.
4. "Akt i Autoritetit" është rregullorja, udhëzimi, manuali apo metodologjia e miratuar nga Bordi i Autoritetit në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin përkatës në fuqi për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse.
5. "Aktuari" është personi i licencuar nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji, i cili, ndër të tjera, ka si detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, tabelave të probabilitetit, provigjoneve dhe dividendëve, duke u mbështetur në teori shkencore që lidhen me investimet, statistikën, matematikën, financën dhe demografinë.

---

[1] *Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës, Numri CELEX: 31973L0239, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 228, datë 16.8.1973, faqe 3–19;*
*Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 korrik 1973, që heq kufizimet mbi lirinë e vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës, Numri CELEX: 31973L0240, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 228, datë 16.8.1973, faqe 20–22;*
*Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet direktiva 73/239/KEE, Numri CELEX: 31988L0357, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 172, datë 4.7.1988, faqe 1–2;*
*Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE (Direktiva e tretë për sigurimet jojetë , Numri CELEX: 31992L0049, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 228, datë 11.8.1992, faqe 1–23;*
*Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jojetë, Numri CELEX: 32002L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L , Nr. 77, datë 20.3.2002, faqe 17–22;*
*Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve, Numri CELEX: 31998L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 330, datë 5.12.1998, faqe 1–12;*
*Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 9 dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime, Numri CELEX: 32002L0092, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 9, datë 15.1.2003, faqe 3–10;*
*Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 nëntor 2005, për risigurimin dhe për ndryshimin e direktivave të Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE, si dhe direktivave 98/78/KE dhe 2002/83/KE (Tekst që lidhet me ZEE-në), Numri CELEX: 32005L0068 , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 323, datë 9.12.2005, faqe 1–50;*
*Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 nëntor 2002, për sigurimin e jetës, Numri CELEX: 32002L0083, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 345, datë 19.12.2002, faqe 1–51;*
*Direktiva 2001/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 19 mars 2001, për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve, Numri CELEX: 32001L0017, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 110, datë 20.4.2001, faqe 28–39.*

6. "Anuiteti" është kontratë sigurimi, nga e cila përfitohen të ardhura për një periudhë kohe, e përcaktuar në numër vitesh ose për gjithë jetën.

7. "Autoriteti" është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

8. "Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës" është autoriteti i vendit anëtar apo të huaj, i autorizuar, sipas legjislacionit përkatës, të ushtrojë mbikëqyrjen mbi veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit.

9. "Bashkësigurim" është shërbimi i ofruar nga disa sigurues me anë të një kontrate të vetme për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga rreziqet e specifikuara në këtë kontratë për një prim të përgjithshëm ose që ofron përfitime, sipas kushteve të kontratës, në masën e paracaktuar, si dhe që kërkon krijimin dhe administrimin e provigjoneve nga çdo sigurues, në përputhje me pjesën e tyre përkatëse të detyrimit.

10. "Cedim" është kalimi i një pjese të rrezikut të siguruar nga një shoqëri sigurimi në një shoqëri risigurimi.

11. "Delegim" është transferimi i një ose disa funksioneve të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit te një person tjetër.

12. "Dëmshpërblim i sigurimit" është çdo shumë, për të cilën siguruesi i detyrohet të siguruarit, përfituesit ose ndonjë pale tjetër të dëmtuar, e cila rrjedh si e drejtë nga një kontratë sigurimi apo veprimtari sigurimi, sipas klasave të parashikuara në aneksin I, të këtij ligji, përfshirë këtu edhe shumat e vëna mënjanë për personat e lartpërmendur, kur disa elemente të detyrimit nuk janë ende të njohura.

13. "Funksionar kryesor" është drejtori i departamentit ose drejtorisë, aktuari dhe drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit.

14. "Familjarë të afërm" janë personat e përcaktuar në nenin 13, pika 3, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

15. "Grup" është një grup shoqërish tregtare i përbërë nga shoqëria mëmë, shoqëritë e kontrolluara të saj, si dhe të gjitha subjektet, mbi të cilat shoqëria mëmë apo shoqëria e kontrolluar e saj ushtron ndikim influencues apo ku zotëron pjesëmarrje.

16. "Institucion financiar" është:

a) një bankë, sipas nenit 4, pika 1.1, dhe/ose një subjekt financiar jo bankë sipas nenit 4, pika 1.31, shkronja "i", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) një shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi;

c) një shoqëri komisionere, sipas përcaktimit të nenit 44, të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, "Për titujt";

ç) një shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 25, të ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive";

d) një shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, sipas përcaktimeve të nenit 4, shkronja "th", të ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar".

17. "Interes i sigurueshëm" është interesi dhe nevoja për t'u mbrojtur nga pasojat e ndodhjes së një ngjarjeje të siguruar.

18. "Joekzekutiv" është anëtari i këshillit të administrimit, i cili nuk është punonjës i shoqërisë së sigurimit dhe nuk është përfshirë në administrimin e saj, si dhe nuk ka asnjë lloj lidhjeje tjetër me shoqërinë e sigurimit.

19. "Klasë sigurimi" është klasifikimi i një grupi të ngjashëm rreziqesh ose operacionesh, që përcakton veprimtarinë që shoqëria e sigurimit mund të ushtrojë në bazë të licencës.

20. "Konsumator" është çdo person që përdor ose përfiton nga shërbimet e ofruara nga siguruesi ose nga shërbimet e ndërmjetësimit.

21. "Kontrollues kryesor" është çdo person fizik, i cili ushtron ndikim tek i licencuari, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një pale të tretë. Këtu përfshihet pa kufizim çdo person, në bazë të drejtimit ose udhëzimeve të të cilit veprojnë anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve dhe funksionarët kryesorë të shoqërisë së sigurimit dhe mendimet e të cilit ndikojnë në procesin vendimmarrës të shoqërisë.

22. "Mbrojtje e interesave të të siguruarve" është ruajtja e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive të sigurimit dhe e të drejtave ligjore të të siguruarve.

23. "Ngjarje e siguruar" është ngjarja e parashikuar në kontratën e sigurimit që ndodh brenda kushteve dhe periudhës së mbuluar nga sigurimi.

24. "Periudhë e mbulimit nga sigurimi" është periudha për të cilën një sigurues mbulon ndodhjen e rrezikut të sigurimit.

25. "Person" është personi fizik dhe/ose juridik.

26. "Përfitues" është personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit apo që përfiton nga kjo e fundit.

27. "Pjesëmarrje e cilësuar" është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i aksioneve me të drejtë vote të një shoqërie sigurimi nga një person juridik ose fizik, i cili, i vetëm apo në bashkëpunim, zotëron 20 për qind ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të shoqërisë së sigurimit.

28. "Pjesëmarrje influencuese" është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të një shoqërie sigurimi nga një person juridik ose fizik, i cili, i vetëm apo në bashkëpunim, zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe rastin kur personi juridik ose fizik zotëron më pak se 10 për qind, por

ushtron ndikim mbi administrimin e shoqërisë së sigurimit.

29. "Portofol sigurimi" është tërësia e kontratave të sigurimit të një klase ose disa klasave të sigurimit të nënshkruara nga një shoqëri sigurimi.

30. "Produkt sigurimi" është kontrata (polica) specifike e përgatitur dhe e lëshuar nga shoqëria e sigurimit për të mbuluar një rrezik specifik ose një numër rreziqesh të veçanta, sipas kushteve të parapërcaktuara.

31. "Provigjon teknik" është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

32. "Provigjon teknik bruto" është shuma totale e provigjoneve teknike që përbëhet nga provigjonet teknike të llogaritura nga siguruesi dhe provigjonet teknike për rreziqet e mbuluara nga risigurimi.

33. "Provigjon matematik" është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas metodave të caktuara aktuariale, e cila mbahet nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin vetëm nga kontratat e sigurimit të jetës.

34. "Retrocedim" është kalimi i një pjese të rrezikut të siguruar nga një shoqëri risigurimi në një shoqëri risigurimi tjetër.

35. "Risigurim" është pranimi i rreziqeve të ceduara nga një shoqëri sigurimi/risigurimi në një shoqëri tjetër risigurimi.

36. "Rrezik sigurimi" është mundësia objektive e ekzistencës së humbjes pasurore dhe/ose jopasurore, e cila ndodh në rrethana të pasigurta, të panjohura dhe të pavarura nga vullneti i personit të siguruar.

37. "Sigurim" është transferimi i një rreziku të mundshëm, i një humbjeje pasurore dhe/ose jopasurore nga i siguruari te siguruesi, sipas një kontrate sigurimi.

38. "Sigurim jete" është sigurimi i rrezikut, sipas klasave të përcaktuara në aneksin I, seksioni B, bashkëlidhur këtij ligji.

39. "Sigurim jojete" është sigurimi i rrezikut, sipas klasave të përcaktuara në aneksin I, seksioni A, bashkëlidhur këtij ligji.

40. "I siguruar" është personi, humbja e mundshme pasurore dhe/ose jopasurore e të cilit është objekt i një kontrate sigurimi. Në kontratat e sigurimit të jetës i siguruari është personi, për jetën e të cilit është lëshuar një kontratë sigurimi.

41. "Sigurues" është shoqëria e sigurimit, e cila merr përsipër sigurimin e një rreziku sipas kontratës së sigurimit.

42. "Shoqatë" është shoqata e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit.

43. "Shoqëri sigurimi" është personi juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe operacione të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

44. "Shoqëri sigurimi/risigurimi vendase" është shoqëri sigurimi/risigurimi e themeluar në Republikën e Shqipërisë.

45. "Shoqëri risigurimi" është personi juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

46. "Shumë e sigurimit" (kufiri i përgjegjësisë) është vlera, për të cilën është rënë dakord midis palëve në kontratën e sigurimit, apo është përcaktuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për sigurimin e detyrueshëm dhe që përfaqëson kufirin maksimal të përgjegjësisë së siguruesit kundrejt të siguruarit/përfituesit.

47. "Vend anëtar" është vendi anëtar i Bashkimit Europian ose një vend tjetër që i përket Zonës Ekonomike Europiane.

48. "Vend i huaj" është çdo vend përveç Republikës së Shqipërisë dhe vendit anëtar.

49. "Veprimtari sigurimi" është përgatitja, ofrimi, nënshkrimi dhe zbatimi i kontratave të sigurimit të jetës dhe jojetës nga shoqëria e sigurimit.

50. "Veprimtari risigurimi" është përgatitja, ofrimi, nënshkrimi dhe zbatimi i kontratave të risigurimit për kalimin nga shoqëria e sigurimit në një shoqëri risigurimi të një pjese apo të të gjithë rrezikut të marrë përsipër nëpërmjet kontratës së sigurimit.

51. "Zotërues i tërthortë" është një person i cili, në emër të personit tjetër zotërues i drejtpërdrejtë, ka përfituar aksione, të drejtë vote ose të drejta të tjera që i japin mbajtësit të tyre të drejtën e pjesëmarrjes në administrim. Një person konsiderohet zotërues i tërthortë nëse zotëruesi i drejtpërdrejtë është i lidhur me atë person.

52. "QKR" është Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

53. "SNRF" janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

54. "OECD" është Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik.

II. Për qëllim të këtij ligji, përveçse kur është përcaktuar ndryshe:

1. Sa herë që në ligj përmendet termi "shoqëri sigurimi", kuptohet edhe "shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi".

2. Sa herë që në ligj përmendet termi "ndërmjetësim në sigurime", kuptohet edhe "ndërmjetësim në sigurime dhe/ose risigurime".

3. Sa herë që në ligj përmendet termi "provigjone teknike", kuptohet "provigjone teknike dhe/ose matematike".

Neni 5

**Klasifikimi i rreziqeve**

1. Klasifikimi i rreziqeve në klasa sigurimi përcaktohet në aneksin I, seksionet A dhe B, bashkëlidhur këtij ligji.

2. Klasifikimi në grupe sigurimi përcaktohet në aneksin II, bashkëlidhur këtij ligji.

3. Klasifikimi i rreziqeve të mëdha përcaktohet në aneksin III, bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 6
**Veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit/risigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi në përputhje me klasat, për të cilat është licencuar nga Autoriteti, dhe përjashtohet nga çdo veprimtari tjetër tregtare.
2. Shoqëria e sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës, nuk ushtron në të njëjtën kohë veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jojetës dhe anasjelltas.
3. Shoqëria e sigurimit mund të ushtrojë veprimtari në risigurime vetëm pasi të ketë marrë licencë të veçantë nga Autoriteti sipas parashikimeve të këtij ligji.
4. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 2, të këtij neni, një shoqëri sigurimi, e licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi në klasat e jetës 19, 20 dhe 21 të seksionit B, aneksi I, mund të licencohet nga Autoriteti, për të ofruar sigurim në klasat 1 dhe 2 të seksionit A, aneksi I, bashkëlidhur këtij ligji, përkatësisht për rreziqet e dëmtimeve trupore, ku përfshihen paaftësia për punë, humbja e jetës, si rezultat i një aksidenti ose invaliditeti që rrjedh nga aksidenti a sëmundja. Në këtë rast, shoqëria e sigurimit administron ushtrimin e dy veprimtarive të ndara nga njëra-tjetra, në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti.
5. Shoqëria e sigurimit, e licencuar për të mbuluar një rrezik kryesor që i përket një apo disa klasave të jojetës, mund të ofrojë sigurim edhe për rreziqe plotësuese të përfshira në klasa të tjera të sigurimit të jojetës, për të cilat nuk është licencuar, nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:
a) Sigurimi mbulon një rrezik, i cili:
i) ka lidhje me rrezikun kryesor;
ii) ka lidhje me objektin e mbuluar nga rreziku kryesor;
iii) mbulohet nga e njëjta kontratë sigurimi;
b) Rreziku i parashikuar në klasën 17 të seksionit A, aneksi I, mund të quhet rrezik plotësues për klasën 18 të seksionit A, aneksi I, nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në shkronjën "a", të kësaj pike, si dhe nëse rreziku kryesor lidhet vetëm me dhënien e asistencës personave në vështirësi gjatë udhëtimit, kur ata ndodhen larg nga vendi i tyre apo vendi ku ata kanë vendqëndrimin;
c) Rreziku i parashikuar në klasën 17 të seksionit A, aneksi I, mund të quhet rrezik plotësues nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në shkronjën "a", të kësaj pike, si dhe nëse ka të bëjë me mosmarrëveshje ose rreziqe që rrjedhin apo lidhen me përdorimin e mjeteve lundruese detare.
6. Me përjashtim të përcaktimeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 5, të këtij neni, rreziqet e përfshira në klasat 14, 15 dhe 17, të seksionit A, të aneksit I, të këtij ligji, nuk mund të quhen si rreziqe plotësuese të klasave të tjera të sigurimit.
7. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, një shoqëri sigurimi mund të kryejë edhe operacione të tjera, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, si më poshtë:
a) ndërmjetësimin në shitje ose shitjen e pronës së dëmtuar, që i përket sigurimit të pronës, e cila gjatë procesit të zgjidhjes së kërkesës për dëmshpërblim, është bërë pronë e shoqërisë së sigurimit;
b) marrjen e masave për minimizimin dhe parandalimin e rreziqeve që mund të kenë pasoja të dëmshme për personat dhe pronën e siguruar;
c) përcaktimin e primit të sigurimit;
ç) vlerësimin e nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut të pronës së siguruar dhe vlerësimin e dëmit;
d) administrimin e fondeve dhe aktiveve të veta, që shërbejnë për të mbuluar provigjonet teknike dhe matematike;
dh) ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në klasën 18, të seksionit A, aneksi I, bashkëlidhur këtij ligji, nëpërmjet angazhimit të punonjësve të shoqërisë së sigurimit dhe përdorimit të pajisjeve të veta;
e) përpunimin e automatizuar të të dhënave;
ë) kryerjen e shërbimeve intelektuale dhe teknike, të lidhura me veprimtarinë e sigurimit.
8. Veprimtaria e risigurimit ushtrohet nga shoqëria e risigurimit e licencuar nga Autoriteti. Shoqëria e risigurimit ushtron vetëm veprimtari risigurimi.
9. Shoqëria e risigurimit mund të ushtrojë veprimtari risigurimi për klasat e sigurimit të jetës, të jojetës ose njëkohësisht për të gjitha klasat e sigurimit të jetës dhe jojetës.

Neni 7
**Personat ose palët e lidhura**

1. Persona ose palë të lidhura quhen personat që janë të lidhur si:
a) familjarë të afërm;
b) anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose përfaqësues apo familjarë të afërm të tyre;
c) aksionar influencues, si dhe familjarë të afërm të tyre;
ç) të punësuar sipas një kontrate pune, si dhe familjarët e tyre të afërm;
d) personat juridikë, në kapitalin e të cilëve personat e parashikuar në shkronjat "a" deri "ç", të kësaj pike, zotërojnë më shumë se 20 për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote;
dh) personat juridikë, në kapitalin e të cilëve shoqëria e sigurimit zotëron më shumë se 20 për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote.
2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, persona ose palë të lidhura janë edhe personat,

marrëdhëniet e të cilëve janë të ndërlidhura në një nga mënyrat e mëposhtme, nëpërmjet:

a) administrimit, kapitalit apo një mënyre tjetër, ku, si rezultat i lidhjeve të tilla, ato bashkërisht krijojnë një politikë biznesi dhe veprojnë në një mënyrë të organizuar, me qëllim arritjen e objektivave të përbashkët të biznesit;

b) ndikimit në marrjen e vendimeve në fushën e financimit dhe administrimit;

c) ndikimit të rëndësishëm që veprimet apo pasojat e veprimeve të një personi mund të kenë në veprimet apo pasojat e veprimeve të një personi tjetër.

Neni 8
**Sigurimi i detyrueshëm**

Veprimtaria e sigurimit të detyrueshëm rregullohet me ligje të veçanta.

Neni 9
**Përjashtimi nga detyrimi për rezervën ligjore**

Shoqëria e sigurimit përjashtohet nga detyrimi për krijimin e rezervës ligjore të parashikuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

KREU II
SHOQËRIA E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT

SEKSIONI I
THEMELIMI I SHOQËRISË SË SIGURIMIT

Neni 10
**Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit**

1. Veprimtaria e sigurimit ushtrohet vetëm nga personat e mëposhtëm:

a) shoqëria e sigurimit, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;

b) dega e një shoqërie sigurimi e një vendi të huaj;

c) shoqëria e sigurimit e një vendi anëtar, e cila ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet degës së saj.

2. Shoqëria e sigurimit e një vendi të huaj nuk duhet të ofrojë dhe të kryejë sigurim të drejtpërdrejtë të një rreziku që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie, që gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet për sigurimin e rreziqeve të lidhura me transportin detar dhe ajror, risigurimin për investimet e huaja, për sigurimin e personit që nuk ka vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë apo kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 11
**Forma juridike e shoqërisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit themelohet vetëm si shoqëri aksionare, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe dispozitave të këtij ligji.

2. Shoqëria e sigurimit regjistrohet në QKR, vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak të Autoritetit për të ushtruar veprimtari sigurimi.

Neni 12
**Emri i shoqërisë së sigurimit dhe gjuha e përdorur**

1. Emri i shoqërisë së sigurimit duhet të përmbajë fjalën "sigurim" ose një derivat të saj në gjuhën shqipe.

2. Emri i shoqërisë së risigurimit duhet të përmbajë fjalën "risigurim" ose një derivat të saj në gjuhën shqipe.

3. Dokumentacioni dhe korrespondenca e mbajtur në Republikën e Shqipërisë nga personat, subjekt i këtij ligji, duhet të jenë në gjuhën shqipe.

4. Asnjë person, i cili nuk është i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi/risigurimi, nuk përdor fjalët "sigurim", "risigurim" ose derivate të tyre për publicitet apo veprimtari të tjera.

Neni 13
**Kapitali minimal fillestar**

1. Kapitali minimal fillestar i shoqërisë së sigurimit nuk mund të jetë më i vogël se shuma minimale e fondit të garancisë, të përcaktuar në nenin 81, të këtij ligji, dhe është tërësisht i pagueshëm në para.

2. Përveç kapitalit minimal fillestar, shoqëria e sigurimit duhet të ketë edhe një fond shtesë, i quajtur më poshtë fond për shpenzime nisjeje, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se 5 për qind e kapitalit minimal fillestar.

3. Aksionarët depozitojnë për llogari të shoqërisë së sigurimit vlerën përkatëse në para të kapitalit minimal fillestar dhe fondit për shpenzime nisjeje në një llogari të veçantë garancie, në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të Republikës së Shqipërisë. Kapitali, sipas pikës 1, të këtij neni, paguhet plotësisht përpara datës së depozitimit në Autoritet të kërkesës për licencim.

Neni 14
**Struktura aksionare**

Shoqëria e sigurimit themelohet nga persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj.

b) anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo komitetit të auditimit të një personi juridik që vepron si vlerësues dëmesh;

c) aksionarë ose punonjës të personit juridik që vepron si vlerësues dëmesh.

2. Kufizimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen edhe për bashkëshortët dhe fëmijët, përfshirë dhe ato në kujdestari.

3. Vlerësuesi i dëmeve nuk duhet të angazhohet në veprimtari tjetër biznesi apo profesion që cenon integritetin, pavarësinë dhe aftësitë profesionale të tij.

4. Vlerësuesi i pavarur i dëmeve nuk mund të jetë punonjës i shoqërisë së sigurimit.

5. Vlerësuesi i dëmeve, në vlerësimin e dëmeve, i referohet treguesve dhe koefiçentëve, të nxjerrë nga institucionet kompetente, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 231

**Bashkëpunimi me palët e interesuara**

1. Vlerësuesi i dëmeve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, mund të kërkojë nga palët e interesuara dokumentet origjinale apo kopje të kontratave të sigurimit, si dhe dokumente të tjera të nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlerësuesi i dëmeve ka të drejtën të mbajë kopje të këtyre dokumenteve.

2. Shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit, të siguruarit, si dhe palët e tjera të interesuara ndihmojnë vlerësuesin në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të pavarur dhe të drejtë.

Neni 232

**Eksperti këshillues**

1. Vlerësuesi i dëmeve, kur është e nevojshme, mund të këshillohet me ekspertë të ndryshëm. Përpara këshillimit vlerësuesi i dëmeve informon, me shkrim, palën e interesuar për identitetin dhe fushën e njohurive që mbulon eksperti përkatës. Eksperti duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë procesit të vlerësimit të dëmit.

2. Konkluzionet e ekspertit quhen të pavlefshme dhe nuk përfshihen në raportin e vlerësuesit të dëmeve nëse nuk zbatohen përcaktimet e pikës 1 të këtij neni.

Neni 233

**Paanshmëria**

1. Vlerësuesi i dëmeve duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur, duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi.

2. Vlerësuesi i dëmeve nuk duhet të kryejë veprimtarinë e vlerësimit të dëmeve nëse ka arsye të forta, të cilat mund të ndikojnë në paanshmërinë e tij në lidhje me një nga palët, ose nëse ka ndonjë lloj afërsie familjare apo lidhjeje biznesi me ndonjë nga palët.

3. Arsye të forta që mund të ndikojnë në paanshmërinë e vlerësuesit, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni, quhen rastet kur vlera e dëmit apo përfitimi i interesit të sigurueshëm i përket vlerësuesit të dëmeve ose nëse ka lidhje ndërmjet vlerësuesit dhe një prej palëve për blerje, dhurim, dhënie me qira, të drejtë përdorimi apo marrëdhënie krediti-debiti. Në këto raste palët mund të zgjedhin një tjetër vlerësues dëmesh.

4. Vlerësuesi i pavarur i dëmit nuk merr asnjë lloj përfitimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që mund të rrezikojnë paanshmërinë e tij, përveç komisionit të vlerësimit të dëmit. Komisioni i vlerësimit të dëmit përcaktohet nga Autoriteti dhe transferohet vetëm në rrugë bankare.

5. Dispozitat e këtij seksioni zbatohen dhe për vlerësuesit e dëmeve, të punësuar nga personi juridik që kryen veprimtari të vlerësimit të dëmeve.

6. Raportet e vlerësimit të dëmit, të cilat hartohen në kundërshtim me dispozitat e këtij seksioni, quhen të pavlefshme.

Neni 234

**Standardet dhe etika profesionale**

1. Vlerësuesi i dëmeve vepron në përputhje me standardet dhe etikën profesionale dhe duhet të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet e tij profesionale.

2. Vlerësuesi i dëmeve ruan raportet e vlerësimit dhe dokumentet, mbi të cilat bazohen këto raporte për një periudhë 5-vjeçare.

3. Vlerësuesi i pavarur i dëmeve dhe personat që punojnë për të duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit, për të cilin marrin dijeni gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe nuk duhet ta përhapin këtë informacion pa marrë paraprakisht miratimin e palëve përkatëse. Ky detyrim përjashton vetëm rastet kur legjislacioni përkatës në fuqi e parashikon ndryshe.

Neni 235

**Mbikëqyrja e vlerësuesve të dëmeve**

1. Mbikëqyrja e aktivitetit të vlerësuesit të dëmeve ushtrohet nga Autoriteti.

2. Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, zbatohen rast pas rasti edhe për mbikëqyrjen e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

KREU XI

BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 236

**Shkëmbimi i informacionit dhe përpunimi i të dhënave**

1. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar, agjenci ose institucione të parandalimit të pastrimit të parave dhe

financimit të terrorizmit, apo institucione të tjera, të njohura me ligj, për të bashkëpunuar ose shkëmbyer informacione.

2. Autoriteti mund të shkëmbejë me autoritetet dhe institucionet vendase apo të huaja:

a) informacionin e kërkuar për lëshimin e licencave;

b) informacionin e kërkuar për subjektet e mbikëqyrura;

c) informacionin e kërkuar, që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ç) informacionin e kërkuar, që lidhet me mashtrimin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve;

d) të dhëna të natyrës financiare;

dh) informacione për personat fizikë që mbajnë poste me përgjegjësi në këto subjekte.

3. Autoriteti bashkëpunon dhe bashkërendon punën me autoritete të tjera mbikëqyrëse apo institucione të tjera, të njohura me ligj, vendase apo të huaja, për administrimin sa më efektiv të krizës në rastin e ofrimit të shërbimeve në sigurime nga një sigurues i caktuar jashtë territorit të vendit ku ndodhet selia e tij qendrore. Autoriteti dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse këshillohen me palën dhënëse të informacionit përpara ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme.

4. Çdo informacion që merr Autoriteti, si dhe çdo informacion që i jepet një autoriteti tjetër mbikëqyrës trajtohet si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes.

5. Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rreth fakteve dhe rrethanave që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij mbikëqyrëse dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

6. Autoriteti mund të miratojë rregulla më të detajuara lidhur me shkëmbimin, përdorimin dhe përpunimin e informacionit të përcaktuar në këtë nen.

Neni 237

**Shkëmbimi i informacionit me vendet anëtare**

1. Dispozitat e përcaktuara pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 236, të këtij ligji, zbatohen edhe për shkëmbimin e informacionit me vendet anëtare.

2. Autoriteti miraton rregulla të mëtejshme për shkëmbimin e informacionit, njoftimin dhe përpunimin e të dhënave me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve anëtare dhe Komisionin Europian.

## KREU XII
## DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 238

**Shoqata**

1. Shoqëritë e sigurimit ose risigurimit mund të krijojnë shoqata sigurimi ose risigurimi që regjistrohen si shoqatë e sigurimeve ose risigurimeve.

2. Anëtarët e shoqatës nuk mund të bien në marrëveshje të shkruar ose verbale me shoqëri të tjera sigurimi apo shoqata sigurimi ose risigurimi, të cilat mund të kufizojnë parimet e ekonomisë për një treg të lirë ose konkurrencë të ndershme në fushën e sigurimeve.

3. Shoqëritë e agjentëve në sigurime, agjentët në sigurime, shoqëritë e brokerimit, brokerat, aktuarët, si dhe vlerësuesit e dëmeve mund të krijojnë shoqatat e tyre përkatëse. Dispozitat e këtij kreu zbatohen rast pas rasti edhe për këto shoqata.

Neni 239

**Parimi i mirëbesimit**

1. Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit hartojnë broshurat dhe artikujt shpjegues, dokumente të tjera dhe reklama, në mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të pasqyrohen qartë të drejtat e përfitimet e të siguruarve dhe nuk bëjnë deklarata të pavërteta, çorientuese, mashtruese ose që krijojnë situatë të një konkurrence të pandershme.

2. Shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit dhe vlerësuesit e dëmeve janë të detyruar që të mos veprojnë në atë mënyrë që rrezikojnë të drejtat dhe përfitimet e të siguruarve. Ato veprojnë në përputhje me legjislacionin dhe parimet e veprimtarisë në sektorin e sigurimeve, si dhe me kërkesat e parimit të mirëbesimit.

3. Autoriteti merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit dhe vlerësuesit e dëmeve të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 240

**Parandalimi i pastrimit të parave dhe mashtrimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve**

1. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit'', të ndryshuar.

2. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit marrin të gjitha masat e nevojshme për zbulimin, parandalimin dhe ndreqjen e rasteve të mashtrimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit raportojnë menjëherë në Autoritet çdo fakt që përbën mashtrim gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve.

## KREU XIII
## KONTRIBUTET, KOMITETET DHE QENDRA E EDUKIMIT

Neni 241

**Tarifa e mbikëqyrjes dhe tarifa të tjera**

1. Shoqëritë e sigurimit, degët e shoqërive të sigurimit të vendeve të huaja/anëtare, për veprimtarinë e tyre gjatë

periudhës së vlefshmërisë së licencës, paguajnë në Autoritet një tarifë mbikëqyrjeje, që përllogaritet kundrejt volumit të primeve të shkruara bruto, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9572 datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". Tarifa e mbikëqyrjes paguhet çdo muaj brenda datës 15 të muajit pasardhës. Pagesa bëhet në llojin e monedhës, me të cilën arkëtohet primi i sigurimit. Autoriteti miraton procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tarifës së mbikëqyrjes.

2. Përveç tarifës së mbikëqyrjes, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, shoqëritë e sigurimit, risigurimit, degët e shoqërive të sigurimit të vendeve të huaja/anëtare, ndërmjetësit, aktuarët, vlerësuesit e dëmeve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë paguajnë në Autoritet tarifa për aplikim për dhënie apo rinovim licence, miratimi apo autorizimi.

3. Nëse licencimi, miratimi apo autorizimi refuzohet nga Autoriteti, tarifa e paguar nuk kthehet.

Neni 242

**Tarifat e tjera**

Autoriteti miraton rregullore për tarifat e tjera, të parashikuara në nenin 241, të këtij ligji, elementet e përllogaritjes e nivelet e këtyre tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

Neni 243

**Komitetet e specializuara**

1. Autoriteti mund të krijojë komitete të specializuara, të përbëra nga persona me njohuri dhe ekspertizë në fushën e sigurimeve, për të kryer kërkime dhe analiza mbi tarifat e primeve dhe kontratat e sigurimeve, të përcaktuara në këtë ligj, si dhe për zhvillimin e sektorit të sigurimeve.

2. Rregullat, që kanë lidhje me krijimin dhe funksionimin e komiteteve të specializuara, përcaktohen nga Autoriteti.

Neni 244

**Qendra e edukimit**

1. Qendra e edukimit ka si objekt organizimin e trajnimeve të nevojshme për formimin profesional të drejtuesve dhe profesionistëve për fushat që mbulon Autoriteti dhe përmbushjen e kërkesave për trajnime që rrjedhin nga marrëveshjet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe qëllime të ngjashme me këto.

2. Qendra e edukimit mund të krijohet nga Autoriteti dhe veprimtaria e saj financohet nga subjektet e mbikëqyrura, personat fizikë e juridikë që përfitojnë nga trajnimet e qendrës, si dhe nga ndihmat financiare e donacionet.

3. Kriteret dhe procedurat e financimit e administrimit të qendrës përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

4. Përjashtimisht nga pika 2, e këtij neni, qendra e edukimit mund të krijohet edhe nga persona të tjerë juridikë. Autoriteti miraton rregulla dhe procedura për kriteret që duhet të përmbushin këta persona për krijimin e qendrës së edukimit të Autoritetit, duke përfshirë edhe objektivat dhe qëllimin që synohet të arrihen nëpërmjet kësaj qendre, sipas pikës 1, të këtij neni.

KREU XIV

SHKELJET E DISPOZITAVE

Neni 245

**Kundërvajtjet administrative**

1. Çdo shkelje me faj e dispozitave të këtij ligji, e kryer me veprim ose mosveprim, për të cilat parashikohen sanksione me gjobë, përbën kundërvajtje administrative.

2. Përveç masave të mbikëqyrjes, të parashikuara në këtë ligj, kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenet e mëposhtme, sanksionohen me gjobë.

3. Kur vendos sanksion me gjobë, Autoriteti siguron që ajo të jetë:

a) e efektshme dhe parandaluese; dhe

b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës.

Autoriteti përcakton shumën e gjobës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke vlerësuar, gjithashtu, natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi interesat e të siguruarve.

4. Autoriteti, gjatë vendosjes së sanksioneve, zbaton parimin e vazhdimësisë, sipas të cilit për shkelje të ngjashme vendosen sanksione të ngjashme.

Neni 246

**Sanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo:

a) ushtron aktivitet në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji;

b) nuk njofton paraprakisht, me shkrim, Autoritetin në rastin kur kërkon të zotërojë pjesëmarrje influencuese në një tjetër shoqëri sigurimi ose institucion financiar, me seli qendrore jashtë territorit të Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 50 të këtij ligji;

c) ushtron veprimtari sigurimi në klasat e sigurimit, për të cilat nuk është licencuar nga Autoriteti për ta ushtruar këtë veprimtari, sipas përcaktimeve të nenit 28 të këtij ligji;

ç) ushtron veprimtari sigurimi pa marrë licencën e dhënë nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 29, të këtij ligji;

d) shkel dispozitat e parashikuara në nenet 57, 63, 64, 66 dhe 69 të këtij ligji;

dh) kryen veprimtari promocionale në kundërshtim me nenin 67 të këtij ligji;

e) nuk emëron aktuarin e autorizuar, sipas përcaktimeve të nenit 223 të këtij ligji;

ë) shkel parashikimet e nenit 226 të këtij ligji;

f) fillon veprimtarinë e sigurimit ose themelon degë të shoqërisë së sigurimit në një vend të huaj/anëtar pa marrë miratimin e Autoritetit, sipas përcaktimeve të neneve 40 dhe 41 të këtij ligji;

g) nuk ka politika e procedura të qarta dhe të hollësishme për identifikimin, matjen dhe monitorimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 74, të këtij ligji;

gj) nuk ka investuar aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, në përputhje me përcaktimet e neneve 96, 97 dhe 98 të këtij ligji;

h) ka risiguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji;

i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;

j) shkel dispozitat e përcaktuara në nenet 100, 101, 102 dhe 103 të këtij ligji;

k) nuk mban librat e kontabilitetit, nuk vlerëson zërat e kontabilitetit dhe nuk harton pasqyrat financiare dhe dokumentet kontabël, në përputhje me përcaktimet e neneve 109 e 110 të këtij ligji;

l) nuk raporton, në përputhje me nenet 111 dhe 112 të këtij ligji;

ll) nuk ka krijuar funksionet e sistemit të administrimit të rrezikut dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me përcaktimet e neneve 27 dhe 121 të këtij ligji;

m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;

n) shkel dispozitat e parashikuara në nenet 261, 267 dhe 268 të këtij ligji;

nj) nuk paraqet gjithë të dhënat dhe informacionin, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 143, të këtij ligji;

o) lidh kontratë ndërmjetësimi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 215, të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 1 000 000 deri në 1 200 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo:

a) nuk njofton Autoritetin për shkarkimin e aktuarit të autorizuar, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 223, të këtij ligji;

b) nuk depoziton në Autoritet pasqyrat financiare dhe raportet e tjera të veprimtarisë së saj të paaudituara, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 111, të këtij ligji;

c) nuk depoziton në Autoritet një kopje të raportit vjetor të audituar, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 8, të nenit 125, të këtij ligji;

ç) pengon në çdo mënyrë personat e autorizuar të Autoritetit në ushtrimin e mbikëqyrjes, sipas përcaktimeve të neneve 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137 dhe 138 të këtij ligji;

d) nuk raporton në Autoritet, në përputhje me përcaktimet e neneve 85 dhe 131 të këtij ligji;

dh) nuk raporton në Autoritet transaksionet brenda grupit, në përputhje me përcaktimet e nenit 144 të këtij ligji;

e) nuk informon Autoritetin për çdo fakt ose rrethanë që mund të jetë e rëndësishme për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë është një grup sigurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, në përputhje me përcaktimet e nenit 148 të tij;

ë) u mundëson kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit personave të tjerë, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në nenet 195, 200, 203 dhe 210 të këtij ligji.

4. Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 247

**Sanksioni me gjobë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës nëse ai:

a) vepron në kundërshtim me përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të këtij ligji;

b) nuk njofton menjëherë Autoritetin, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 131, të këtij ligji.

Neni 248

**Sanksioni me gjobë ndaj agjentit dhe shoqërisë së agjentëve**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë ndaj shoqërisë së agjentëve nëse ajo:

a) shkel dispozitat e neneve 63 dhe 64 të këtij ligji;

b) nuk zotëron policën e përgjegjësisë profesionale, në përputhje me përcaktimet e nenit 197 të këtij ligji;

c) nuk ushtron veprimtari të shoqërisë së agjentëve, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 200, të këtij ligji;

ç) merr në kontroll ose bashkohet me një shoqëri tjetër agjentësh, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, të nenit 212, të këtij ligji;

d) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 216, të këtij ligji;

dh) nuk depoziton në Autoritet pasqyrat financiare vjetore ose 6-mujore brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 217, të këtij ligji;

e) nuk depoziton në Autoritet raportin statistikor brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 4, të nenit 217, të këtij ligji;

ë) nuk raporton në Autoritet, në përputhje me përcaktimet e nenit 218 të këtij ligji;

f) nuk njofton paraprakisht në Autoritet fillimin e veprimtarisë së agjentit në një vend anëtar/të huaj, sipas përcaktimeve të nenit 221 të këtij ligji;

g) pengon personin e autorizuar nga Autoriteti për të ushtruar mbikëqyrje, sipas përcaktimeve të neneve 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137 dhe 138 të këtij ligji;

gj) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 215, të këtij ligji, lejon kryerjen e veprimtarisë së agjentit për llogari të saj nga persona të tjerë, përveç atyre të përmendur në nenin 195 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i shoqërisë së agjentëve sanksionohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë, për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 deri në 300 000 lekë ndaj agjentit nëse ai:

a) ushtron veprimtari në kundërshtim me pikën 3, të nenit 198, të këtij ligji;

b) nuk i jep informacion ose i jep informacion të pasaktë të siguruarit, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 213, të këtij ligji, ose nuk e jep informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 214 të tij;

c) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 216, të këtij ligji.

Neni 249

**Sanksioni me gjobë ndaj brokerit dhe shoqërisë së brokerimit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 800 000 deri në 1 000 000 lekë ndaj shoqërisë së brokerimit nëse ajo:

a) shkel dispozitat e neneve 63 dhe 64 të këtij ligji;

b) nuk zotëron policën e përgjegjësisë profesionale, në përputhje me përcaktimet e nenit 205 të këtij ligji;

c) nuk ushtron veprimtari brokerimi si veprimtari të vetme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 204, të këtij ligji;

ç) merr në kontroll ose bashkohet me një shoqëri tjetër brokerimi, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, të nenit 212, të këtij ligji;

d) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 216, të këtij ligji;

dh) shkel përcaktimet e pikës 3, të nenit 216, të këtij ligji;

e) nuk depoziton në Autoritet pasqyrat financiare vjetore ose 6-mujore brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 217, të këtij ligji;

ë) nuk depoziton në Autoritet raportin statistikor brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 4, të nenit 217, të këtij ligji;

f) nuk raporton në Autoritet, në përputhje me përcaktimet e nenit 218 të këtij ligji;

g) nuk njofton paraprakisht në Autoritet fillimin e veprimtarisë së brokerimit në një vend anëtar, sipas përcaktimeve të nenit 221 të këtij ligji;

gj) pengon personin e autorizuar nga Autoriteti për të ushtruar mbikëqyrje, sipas përcaktimeve të neneve 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137 dhe 138 të këtij ligji;

h) në kundërshtim me pikën 3, të nenit 215, të këtij ligji, lejon kryerjen e veprimtarisë së brokerimit për llogari të saj nga persona të tjerë, përveç atyre të përmendur në nenin 203 të tij.

2. Personi përgjegjës i shoqërisë së brokerimit sanksionohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 500 000 deri në 800 000 lekë ndaj brokerit nëse ai:

a) nuk përmbush detyrimet e tij, në përputhje me nenin 206 të këtij ligji;

b) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, vepron në kundërshtim me pikën 1, të nenit 207, të këtij ligji;

c) gjatë kryerjes së veprimeve përgatitore për nënshkrimin e kontratës, nuk informon shoqërinë e sigurimit për rreziqet që ka ose mund të kishte dijeni, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 207, të këtij ligji;

ç) nuk është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari brokerimi, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 209, të këtij ligji;

d) nuk i jep informacion ose i jep informacion të rremë të siguruarit, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 213, të këtij ligji, ose nuk e jep informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 214 të tij;

dh) nuk bën analizën e rrezikut, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 213, të këtij ligji;

e) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 216, të këtij ligji;

ë) shkel përcaktimet e pikës 3, të nenit 216, të këtij ligji.

Neni 250

**Sanksioni me gjobë ndaj grupit të sigurimit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë ndaj një grupi kontrollues financiar, grupi kontrollues të sigurimit të përzier, grupi kontrollues të sigurimit, grupi kontrollues të sigurimit me aktivitet të përzier, grupi kontrollues financiar të përzier apo shoqërie siguruese ose risiguruese mëmë në një grup sigurimi, nëse nuk raporton mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit të sigurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 146 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i grupit kontrollues financiar, grupit kontrollues të sigurimit të përzier, grupit kontrollues të sigurimit, grupit kontrollues të sigurimit me aktivitet të përzier, grupit kontrollues financiar të përzier apo shoqëria siguruese ose risiguruese mëmë në një grup sigurimi

sanksionohen me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 251
**Sanksioni me gjobë ndaj personave të tjerë**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë ndaj personave të tjerë juridikë nëse ata:

a) ushtrojnë veprimtari sigurimi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 10, të këtij ligji;

b) ushtrojnë veprimtari risigurimi në kundërshtim me pikën 8, të nenit 6, të këtij ligji;

c) ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi në kundërshtim me nenet 200 dhe 210 të këtij ligji;

ç) ushtrojnë veprimtari si vlerësues dëmesh në kundërshtim me nenet 226 dhe 227 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik sanksionohet me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 deri në 400 000 lekë ndaj personave të tjerë fizikë nëse:

a) ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi në kundërshtim me nenet 199, 209 dhe 210 të këtij ligji;

b) ushtrojnë veprimtarinë e agjentit në kundërshtim me pikën 5, të nenit 200, të këtij ligji;

c) ushtrojnë veprimtari si vlerësues dëmesh në kundërshtim me nenet 226 dhe 227 të këtij ligji.

4. Autoriteti vendos sanksion me gjobë 200 000 lekë ndaj personave të palicencuar, sipas dispozitave të këtij ligji, të cilët përdorin emrin "sigurim ose risigurim" apo derivate të tij ose kryejnë veprimtari promocionale, me qëllim përfitimin e të mirave materiale.

Neni 252
**Sanksioni me gjobë ndaj aktuarit të autorizuar**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 deri në 400 000 lekë ndaj aktuarit të autorizuar nëse ai:

a) ka ushtruar veprimtari aktuariale në kundërshtim me nenin 224 të këtij ligji;

b) nuk njofton shoqërinë e sigurimit, në përputhje me përcaktimet e pikës 4, të nenit 225, të këtij ligji;

c) nuk njofton Autoritetin në përputhje me përcaktimet e pikave 6 dhe 7, të nenit 225, të këtij ligji.

Neni 253
**Sanksioni me gjobë ndaj vlerësuesit të dëmeve**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë ndaj vlerësuesit të dëmeve në sigurime nëse ai:

a) nuk zotëron policën e përgjegjësisë profesionale, në përputhje me përcaktimet e nenit 229 të këtij ligji;

b) shkel dispozitat e pikës 1, të nenit 230, të këtij ligji;

c) ushtron veprimtarinë në kundërshtim me parimet e nenit 233 të këtij ligji;

ç) ushtron veprimtarinë në kundërshtim me standardet e përcaktuara në nenin 234 të këtij ligji.

Neni 254
**Sanksione me gjobë ndaj administratorit të përkohshëm**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë ndaj administratorit të përkohshëm nëse ai:

a) nuk depoziton në Autoritet raportin mbi gjendjen financiare dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në kushtet e administrimit të përkohshëm, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 166, të këtij ligji;

b) nuk depoziton në Autoritet raportin mbi gjendjen financiare dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në kushtet e administrimit të përkohshëm, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 166, të këtij ligji;

c) nuk thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 167 të këtij ligji.

Neni 255
**Sanksioni me gjobë për ruajtjen e konfidencialitetit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë ndaj personave të përmendur në pikën 1, të nenit 72, të këtij ligji, nëse shkelin detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimeve të këtij neni.

2. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë ndaj personave të përmendur në pikën 4, të nenit 72, të këtij ligji, nëse shkelin detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimeve të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë ndaj personit përgjegjës, nëse shkel detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimeve të nenit 72 të këtij ligji.

Neni 256
**Shkelje të tjera**

1. Për çdo shkelje tjetër të këtij ligji, Autoriteti:

a) vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 1 000 000 lekë;

b) urdhëron shoqërinë e sigurimit për shkarkimin e një ose të disa anëtarëve të këshillit të administrimit /mbikëqyrës dhe/ose administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve apo pezullimin e personave në fjalë për një periudhë të caktuar kohore.

2. Autoriteti, nëse e gjykon të arsyeshme, paralajmëron shoqërinë e sigurimit për shkarkimin apo pezullimin e personave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 257
**Përsëritja e shkeljeve**

Autoriteti, në rast të përsëritjeve të shkeljeve, mund të vendosë dyfishimin e sanksioneve të parashikuara nga nenet 246 e në vijim të këtij ligji.

Neni 258
**Njoftimi**

Autoriteti njofton shoqërinë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime, degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, si dhe personat përgjegjës për çdo sanksion të dhënë, në përputhje me nenet 246 e në vijim, të këtij ligji, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

Neni 259
**Ekzekutimi i vendimeve**

1. Sanksionet me gjobë, të parashikuara në nenet 246 e në vijim, të këtij ligji, arkëtohen në një llogari qëllimore të Autoritetit, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, e përcaktuar në nenin 258 të këtij ligji.

2. Kur shuma e gjobës që duhet paguar nuk është shlyer brenda afatit, shoqëria e sigurimit dhe personi përgjegjës paguajnë një interes prej 0,01 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni.

3. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

KREU XV
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 260
**Përshtatja e shoqërive të sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit e cila, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka licencë për të ushtruar një veprimtari sigurimi dhe është e regjistruar në QKR, vazhdon të ushtrojë veprimtari sigurimi sipas dispozitave të këtij ligji në klasat e sigurimit të përcaktuara në licencën ekzistuese.

2. Brenda një periudhe 1-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të përshtatë:

a) strukturën aksionare të shoqërisë, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;

b) organizimin e shoqërisë së sigurimit, në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;

c) anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, në përputhje me nenet 17, 20 e 22 të këtij ligji;

ç) komitetin e auditimit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji;

d) çdo element tjetër të veprimtarisë së saj, në përputhje me dispozitat e tjera përkatëse të këtij ligji.

3. Shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e detyruar që, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 2, të depozitojë në Autoritet një raport për përshtatjen e shoqërisë, në përputhje me pikën 2, të këtij neni. Raporti shoqërohet nga:

a) statuti i shoqërisë së sigurimit;

b) një listë e aksionarëve, duke përfshirë informacionet individuale, si dhe emrin dhe adresën e selisë qendrore, shumën totale nominale të aksioneve dhe shumën e zotërimeve, të shprehura në përqindje të kapitalit të shoqërisë së sigurimit;

c) në rastin e aksionarëve si persona juridikë dhe të cilët kanë pjesëmarrje influencuese depozitojnë:

i) ekstrakt të QKR-së;

ii) kur aksionari është shoqëri aksionare, përveç informacionit të sipërpërmendur, një ekstrakt të regjistrit të aksionarëve; në rast të aksionarëve persona juridikë të huaj duhet të përfshihen dokumentet e përkthyera në shqip dhe të noterizuara;

iii) pasqyrat financiare për 2 vitet e fundit financiare.

ç) lista e personave të lidhur me personat që kanë pjesëmarrje influencuese së bashku me një përshkrim të llojit të lidhjes së tyre.

4. Brenda një periudhe 6-mujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e detyruar:

a) të emërojë aktuarin e autorizuar, sipas përcaktimeve të nenit 223 të këtij ligji;

b) të krijojë sistemin e administrimit të rrezikut, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji;

c) të krijojë sistemin e kontrollit të brendshëm, në përputhje me nenet 121 dhe 122 të këtij ligji.

5. Shoqëria e sigurimit , brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, depoziton në Autoritet një raport për përshtatjen e shoqërisë, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij neni.

6. Autoriteti miraton vazhdimësinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit nëse raportet e përmendura në pikat 3 dhe 5, të këtij neni, dhe dokumentacioni plotësues i tyre tregon që shoqëria e sigurimit është përshtatur.

7. Autoriteti mund të revokojë licencën e shoqërisë së sigurimit dhe të hapë procedurat e likuidimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nëse shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.

Neni 261
**Përshtatja e shoqërisë së sigurimit, e cila ushtron veprimtari sigurimi jete dhe jojete**

1. Shoqëria e sigurimit INSIG, sh. a., e cila në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në bazë të licencës ekzistuese,

ushtron veprimtari sigurimi jete dhe jojete, nuk është e detyruar të përshtatë veprimtarinë e saj, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të këtij ligji, deri në privatizimin e saj.

2. Shoqëria e sigurimit INSIG, sh. a., e cila ushtron veprimtari sigurimi, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, është e detyruar:

a) të mbajë librat tregtarë/kontabël dhe të hartojë pasqyra financiare të ndara për veprimtarinë në klasat e jetës dhe klasat e jojetës;

b) të llogarisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me nenin 75, të këtij ligji, të ndarë për klasat e jetës dhe klasat e jojetës.

3. Pas privatizimit, shoqëria INSIG, sh. a., është e detyruar të përshtatë veprimtarinë e saj, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të këtij ligji.

Neni 262

**Sigurimi i drejtpërdrejtë**

1. Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me sigurimin e drejtpërdrejtë nga një shoqëri sigurimi e një vendi anëtar në Republikën e Shqipërisë, zbatohen vetëm në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

2. Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me sigurimin e drejtpërdrejtë të një shoqërie sigurimi vendase në një vend anëtar, zbatohen vetëm në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

3. Deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, me "vend të huaj" nënkuptojmë edhe vendin anëtar dhe dispozitat përkatëse zbatohen rast pas rasti.

Neni 263

**Investimet e lejuara të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në një vend anëtar ose në një vend anëtar të OECD-së**

1. Duke filluar nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë aktivet në mbulim të provigjoneve teknike në një vend anëtar ose në një vend anëtar të OECD-së, sipas llojeve të investimeve, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 97, të këtij ligji, dhe kufizimeve të përcaktuara sipas pikës 5, të nenit 97, të këtij ligji dhe, si rrjedhojë, pika 3, e nenit 97, të këtij ligji, shfuqizohet.

2. Duke filluar nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë aktivet në mbulim të provigjoneve matematike në një vend anëtar ose në një vend anëtar të OECD-së, sipas llojeve të investimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 103, të këtij ligji, dhe kufizimeve të përcaktuara sipas pikës 5, të nenit 103, të tij, dhe, për rrjedhojë, pika 3, e nenit 103, të këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 264

**Përshtatja e shoqërisë së agjentëve dhe shoqërisë së brokerimit**

1. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, e cila, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka licencë për të ushtruar një veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe është e regjistruar në QKR, përshtat veprimtarinë e saj me dispozitat e këtij ligji brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

2. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e detyruar që, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të depozitojë në Autoritet një raport për përshtatjen e veprimtarisë, në përputhje me këtë ligj, si dhe dokumentacionin shoqërues përkatës.

3. Nëse raportet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe dokumentacioni përkatës tregojnë se shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit janë përshtatur në përputhje me pikën 1, të këtij neni, Autoriteti miraton vazhdimësinë e veprimtarisë së shoqërisë së ndërmjetësimit.

4. Nëse shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, referuar pikës 1, të këtij neni, nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të tij, Autoriteti revokon licencat dhe hap procedurat e likuidimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 265

**Përshtatja e agjentit dhe brokerit në sigurime**

1. Personat, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë veprimtari si agjent ose si broker në sigurime, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji përshtatin veprimtarinë e tyre me dispozitat e tij.

2. Agjenti dhe brokeri, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, janë të detyruar që, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të depozitojë në Autoritet një raport për përshtatjen e veprimtarisë, në përputhje me këtë ligj, si dhe dokumentacionin shoqërues përkatës.

3. Nëse raportet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe dokumentacioni përkatës tregojnë që agjenti dhe brokeri janë përshtatur në përputhje me pikën 1, të këtij neni, Autoriteti miraton vazhdimësinë e veprimtarisë së agjentit dhe brokerit.

4. Nëse agjenti ose brokeri në sigurime, referuar pikës 1, të këtij neni, nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të tij, Autoriteti revokon miratimin apo licencën ekzistuese.

Neni 266

**Përshtatja e procedurave**

1. Të gjitha procedurat për marrjen e licencës, miratimeve, lejimeve dhe autorizimeve, të cilat kanë filluar

para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në momentin e hyrjes së tij në fuqi nuk kanë përfunduar, kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Personat e licencuar si aktuarë dhe vlerësues dëmesh në sigurime përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë veprimtarinë e tyre, sipas licencës ekzistuese, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

## KREU XVI
## DISPOZITA TË TJERA

### Neni 267
### Shndërrimi i degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar

1. Shoqëria e sigurimit e vendimit të huaj/anëtar, e cila ushtron veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet degës së saj, në bazë të licencës së lëshuar nga Autoriteti, mund të shndërrojë degën e saj në një shoqëri të kontrolluar, në formën e shoqërisë aksionare, nëpërmjet regjistrimit të kapitalit të dhuruar në aksione të nënshkruara nga shoqëria e sigurimit të vendit të huaj/anëtar.

2. Shndërrimi i degës së shoqërisë së vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, mund të ndodhë me kërkesë të vetë shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar ose, kur gjykohet e nevojshme nga Autoriteti, për arsye të administrimit të rrezikut. Kur shndërrimi kërkohet nga shoqëria e sigurimit të vendit të huaj/anëtar, kërkesa duhet miratuar nga Autoriteti, i cili mund të refuzojë të japë miratimin, nëse gjykon se shndërrimi mund të dëmtojë ekonominë kombëtare apo interesat shtetërorë, ose nëse çmon se nga shndërrimi mund të përkeqësohet gjendja financiare apo respektimi i normave mbikëqyrëse.

3. Në rastin e shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar të shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, kapital do të quhet shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit, të certifikuara nga shoqëria audituese:

a) kapitali i dhuruar i paguar;

b) provigjonet;

c) diferenca rivlerësimi;

ç) fitimet e pashpërndara;

d) fitim/humbja e vitit ushtrimor.

4. Në rastin e shndërrimit, kapitali i shoqërisë së sigurimit ose pjesë të tij nuk duhet të bien nën nivelin e kapitalit minimal fillestar të kërkuar për licencimin e një shoqërie sigurimi.

5. Procesi i shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase kryhet brenda 3 muajve nga miratimi i kërkesës së shoqërisë së sigurimit të huaj/vendit anëtar nga Autoriteti dhe brenda 6 muajve kur shndërrimi është kërkuar me vendim të Autoritetit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Autoritetit. Në rast të refuzimit të shndërrimit ose të mosrespektimit të afatit për kryerjen e procesit të shndërrimit, Autoriteti mund të marrë masat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë ligj, si dhe mund të revokojë licencën e degës së shoqërisë të vendit të huaj/anëtar dhe ta vendosë atë në likuidim të detyruar.

6. Procesi i shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase, me kërkesë të vetë shoqërisë së sigurimit, hyn në fuqi me regjistrimin pranë QKR-së të vendimit për shndërrim të asamblesë së përgjithshme ose organit tjetër përgjegjës të shoqërisë së sigurimit mëmë, së bashku me vendimin e Autoritetit për miratimin e shndërrimit.

7. Procesi i shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase me vendim të Autoritetit hyn në fuqi me njoftimin e këtij vendimi përfaqësuesve ligjorë të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar dhe/ose shoqërisë së sigurimit mëmë ose në datën e përcaktuar nga kjo e fundit në vendimin për shndërrim. Ky vendim njoftohet pranë QKR-së dhe mund të publikohet pas realizimit të procesit të shndërrimit.

8. Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që:

a) shoqëria e sigurimit mëmë e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, që shndërrohet, të marrë pjesë në kapitalin aksionar të shoqërisë së sigurimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;

b) të drejtat e shoqërisë së sigurimit mëmë dhe të personave të tretë ndaj degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, që shndërrohet, të vazhdojnë të zbatohen edhe për shoqërinë e kontrolluar.

### Neni 268
### Procedura e shndërrimit

1. Dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, që shndërrohet, paraqet në Autoritet një raport të hollësishëm, ku shpjegohen bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar dhe/ose arsyet përkatëse. Raporti duhet të përmbajë dhe përshkrimin e vështirësive të veçanta të vlerësimit të shndërrimit që janë hasur, si dhe të përshkruajë efektin që parashikohet të ketë shndërrimi te normat rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe te punëmarrësit e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar.

2. Vendimi për shndërrimin e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, kur shndërrimi kërkohet nga shoqëria e sigurimit të vendit të huaj/anëtar, duhet të merret nga asambleja e përgjithshme ose organi tjetër kompetent i shoqërisë së sigurimit mëmë. Nëse shndërrimi ka si pasojë ndryshimin e të drejtave dhe të detyrimeve të

veçanta të aksionarëve, atëherë vlefshmëria e vendimit për shndërrim i nënshtrohet miratimit të aksionarëve të prekur, sipas kërkesave të legjislacionit tregtar përkatës.

3. Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, zbatohen përkatësisht nenet 221, 222 e 223, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

4. Për përgjegjësitë ligjore të anëtarëve të drejtorisë dhe administratorëve të tjerë të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shndërrim për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre, gjatë kryerjes së shndërrimit, zbatohen, përkatësisht, dispozitat e nenit 224, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Neni 269

**Efektet juridike të shndërrimit**

1. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Shoqëria e kontrolluar e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar trashëgon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria e degës së shoqërisë të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit, përfshirë totalin e primeve të grumbulluara. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit, në raport me palë të treta, para hyrjes në fuqi të procesit të shndërrimit, vazhdojnë të mbeten në fuqi për shoqërinë e sigurimit pas shndërrimit, sipas përcaktimeve në aktet apo marrëveshjet përkatëse me këto palë.

2. Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve, sipas pikës 1, të këtij neni, kur shndërrimi ndodh, sepse gjykohet i nevojshëm nga Autoriteti, kryhet pa qenë e nevojshme të merret pëlqimi paraprak i depozituesve, kreditorëve të tjerë, aksionarë me të drejta të veçanta ose palëve të tjera, të treta.

3. Me hyrjen në fuqi të procesit të shndërrimit, të gjitha aktivet financiare dhe fizike në pronësinë ose administrimin e degës së shoqërisë të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit vazhdojnë të mbeten në pronësi ose administrim të filialit.

4. Për efekt të regjistrimit tatimor, shoqëria e sigurimit vazhdon të mbajë numrin e NIPT-it që ka në përdorim dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit.

5. Shoqëria e kontrolluar, e krijuar si rrjedhojë e shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar nuk i nënshtrohet një procedure të re licencimi nga Autoriteti, por ky i fundit verifikon kushtet e përcaktuara në aktet ligjore dhe aktet e Autoritetit, duke miratuar ose refuzuar shndërrimin e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri sigurimi. Në rast se Autoriteti miraton shndërrimin, shoqëria e sigurimit trashëgon licencën e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar të shndërruar. Në këtë rast Autoriteti pajis shoqërinë e kontrolluar/shoqërinë e sigurimit vendase me formatin e ri të licencës që reflekton ndryshimin e emërtimit nga degë e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri sigurimi.

6. Pas realizimit të procesit të shndërrimit, shoqëria e kontrolluar regjistrohet në regjistrin tregtar të QKR-së, ndërkohë që dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar çregjistrohet nga ky regjistër.

7. Shoqëria e kontrolluar i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Autoriteti, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe aktet e Autoritetit të nxjerra në bazë të tij. Shoqëria e kontrolluar respekton të gjitha normat dhe kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe aktet e Autoritetit, të miratuara në bazë të këtij ligji.

8. Autoriteti mund të miratojë rregulla të mëtejshme në lidhje me shndërrimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e shoqërive të kontrolluara.

Neni 270

**Miratimi i rregulloreve**

1. Autoriteti miraton aktet, sipas kompetencave të dhëna nga ky ligj, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e tij.

2. Deri në hyrjen në fuqi të akteve, referuar pikës 1, të këtij neni, aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të ndryshuar, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 271

**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9267, datë 29.7.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 272

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.5.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8597, datë 17.6.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

ANEKSI I
KLASAT E SIGURIMIT

A. Veprimtaria e sigurimit të jojetës përfshin klasat e mëposhtme:

1. Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale) mbulon:

1.1 pagesën e një shume të caktuar monetare (pagesa e menjëhershme e plotë);

1.2 përfitim me natyrë rimbursimi (pagesa e shumës së sigurimit me këste);

1.3 kombinimin e 1.1 dhe 1.2;

1.4 pagesën ndaj dëmtimeve shëndetësore ose vdekjes së pasagjerëve.

2. Sigurimi i sëmundjeve mbulon:

2.1 të ardhura fikse financiare nga paaftësia shëndetësore;

2.2 përfitime me natyrë rimbursimi;

2.3 kombinimin e 2.1 dhe 2.2.

3. Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina) mbulon dëmtimet ose humbjet nga:

3.1 mjetet tokësore motorike;

3.2 mjetet tokësore jomotorike.

4. Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina.

5. Sigurimi i avionëve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuara nga mjetet ajrore.

6. Sigurimi i anijeve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuara nga:

6.1 anijet lumore dhe të kanaleve;

6.2 anijet e liqeneve;

6.3 anijet detare.

7. Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve) mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë transportit ose bagazhet, pavarësisht nga mënyra e transportit.

8. Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës mbulon dëmtimin ose humbjen e sendeve (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7), të shkaktuara nga:

8.1 zjarret;

8.2 shpërthimet;

8.3 stuhitë;

8.4 forcat e natyrës të ndryshme nga stuhia;

8.5 energjia nukleare;

8.6 shkarja e tokës dhe tërmeti.

9. Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri (të ndryshme nga ato që përfshihen në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7), kur dëmi është shkaktuar nga breshëri ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhja, të ndryshme nga ato të përmendura në klasën 8.

10. Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit dhe mbulimin e përgjegjësisë së detyrueshme).

11. Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

12. Sigurimi i përgjegjësive për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

13. Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme mbulon të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në klasat 10, 11 dhe 12.

14. Sigurimi i kreditit mbulon:

14.1 rrezikun e mospagesës për shkak të paaftësisë paguese (e përgjithshme);

14.2 kreditë e eksportit dhe rreziqe të tjera që shoqërohen me eksportin, tregtinë dhe investimet brenda dhe jashtë vendit;

14.3 kreditë e shlyera me këste;

14.4 kreditë hipotekore dhe huatë Lombard;

14.5 kreditë bujqësore;

14.6 kredi të tjera.

15. Sigurimi i garancive mbulon:

15.1 garancitë e drejtpërdrejta;

15.2 garancitë e tërthorta.

16. Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare mbulon humbjet financiare të shkaktuara si pasojë e:

16.1 rrezikut në punësim;

16.2 pamjaftueshmërisë së të ardhurave (e përgjithshme);

16.3 motit të keq;

16.4 humbjes së të ardhurave;

16.5 shpenzimeve të përgjithshme të vazhdueshme dhe shpenzimeve të tjera;

16.6 shpenzimeve tregtare dhe operacionale të paparashikuara;

16.7 humbjes së vlerës në treg;

16.8 humbjes nga qiratë ose të ardhurat;

16.9 humbjes indirekte nga tregtimi, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër;

16.10 humbjeve financiare (të tjera nga ato tregtare);

16.11 llojeve të tjera të humbjeve financiare.

17. Sigurimi i mbrojtjes ligjore mbulon:

17.1 shpenzimet për shërbimet ligjore dhe ato gjyqësore, si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore.

18. Sigurimi i asistencës (ndihmës) mbulon:

18.1 ndihmën për personat që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve ose në raste të tjera të largësisë nga shtëpia ose vendbanimi i përhershëm.

B. Veprimtaria e sigurimit të jetës përfshin klasat e mëposhtme:

19. Sigurimi i jetës mbulon:

19.1 sigurimin për vdekjen;

19.2 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;

19.3 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;

19.4 sigurimin e jetës me kthim të primeve.

20. Sigurimi martesë - lindje mbulon:

20.1 shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;

20.2 përfundimi i kushteve të sigurimit, i cili ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.

21. Sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive mbulon:

21.1 sigurimin e jetës, në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.

22. Anuitetet mbulojnë:

22.1 sigurim jete me elemente kursimi;

22.2 sigurim jete me afat të përcaktuar;

22.3 anuitete të shtyra;

22.4 anuitete të menjëhershme.

23. Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

a) vdekje si rezultat i aksidentit;

b) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;

c) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;

ç) paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;

d) paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;

dh) paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;

e) shërbimet spitalore;

ë) sëmundjet e pashërueshme;

f) shërbimet mjekësore.

C. Veprimtaria e sigurimit të jetës, gjithashtu, përfshin edhe operacionet e mëposhtme në sigurime:

1. Sigurimi i individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizimit të kontributeve të tyre dhe shpërndarjes së aktiveve në raport me fondet e akumuluara midis personave që kanë arritur një moshë të caktuar (të mbijetuarve) ose midis përfituesve të sigurimit në rast vdekjeje të personave të siguruar.

2. Kthimi i kapitalit, i cili është një lloj sigurimi për një periudhë të caktuar, ku siguruesi, në këmbim të primeve, bie dakord në pagesën e një shume të caktuar në përfundim të periudhës së rënë dakord.

3. Administrimi i investimeve të fondeve të pensioneve dhe në veçanti të aktiveve, të cilat përfaqësojnë rezervat e subjekteve, të cilat kanë ndikim mbi pagesat në rast vdekjeje apo mbijetese apo në rast të mosvazhdimit ose përfundimit të veprimtarisë.

## ANEKSI II
## EMËRTIMI I LICENCËS SË DHËNË PËR MË SHUMË SE NJË KLASË SIGURIMI

Nëse licenca për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e jojetës mbulon në të njëjtën kohë më shumë se një klasë sigurimi emërtohet:

a) klasat nr. 1 dhe 2, "Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit";

b) klasat nr. 1 (paragrafi i katërt), 3, 7 dhe 10, "Sigurime motorike";

c) klasat nr. 1 (paragrafi i katërt) 4, 6, 7 dhe 12, "Sigurimi i marinës dhe transportit";

ç) klasat nr. l (paragrafi i katërt) 5, 7 dhe 11, "Sigurimi i avionëve";

d) klasat nr. 8 dhe 9, "Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë";

dh) klasat nr. 10, 11, 12 dhe 13, "Sigurimi i përgjegjësive";

e) klasat nr. 14 dhe 15, "Sigurimi i kreditit dhe i garancisë";

ë) të gjitha klasat emërtohen "Të gjitha klasat e sigurimit të jojetës".

## ANEKSI III
## RREZIQET E MËDHA

1. Rreziqet e mëdha në sigurime, në kuptim të këtij ligji, janë si më poshtë:

a) rreziqet e klasifikuara në klasat 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12, të aneksit I;

b) rreziqet e klasifikuara në klasat 14 dhe 15, të aneksit I, nëse i siguruari kryen veprimtari industriale ose tregtare ose është i vetëpunësuar dhe rreziqet në fjalë lidhen me këtë veprimtari;

c) rreziqet e klasifikuara në klasat 3, 8, 9, 10, 13 dhe 16, të aneksit I, nëse i siguruari përmbush të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:

i) totali i bilancit është në vlerën 900 milionë lekë;

ii) fitimi është në vlerën 1 800 milionë lekë;

iii) ka të punësuar mesatarisht në një vit financiar 250 punonjës.

2. Nëse i siguruari është pjesë e një grupi, kushtet e përcaktuara në pikën 1, shkronja "c", e këtij neni do të zbatohen duke u bazuar mbi pasqyrat financiare të konsoliduara.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)


| | |
|---|---|
| | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 76 lekë



Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006